



Data: 05.04.2019

Ref.: 563/1910

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 66-të, të mbajtur më 27 mars 2019, mori:

## V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Nr.442/19H, datë 18.03.2019 e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, si e bazuar.
- II. Ndryshohet pika I (një) e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.189/19D, datë 11.02.2019.
- III. Aprovohet aplikacioni i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren për riakreditim të programit të studimit:
  - Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake).
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.189/19D, datë 11.02.2019 mbetet e pandryshuar.

## Arsyetimi

KSHC me vendim Nr. 189/19D, datë 11.02.2019 ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren për këto programe të studimit: Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake), dhe Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BSc, 240 ECTS .

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.189/19D, datë 11.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 18.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).

Përmes kësaj ankesa, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programet e studimit, Programi Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake), i cilat kanë qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.145/19D, datë 05.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 66-të të KShC-së, të mbajtur me 27 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programin e studimit, Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake), i plotësojnë kushtet për të qen bartës të programit të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Bazuar në nenin 26 pika 5.3.10 e UA për Akreditim "Programet e studimit në gjuhën e komuniteteve (boshnjake dhe turke) në universitetet publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri me tani, të cilat kanë mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, do të lejohen të ofrohen paralelisht me programet e ofruara në gjuhën shqipe, me kushte që brenda periudhës kalimtare prej pesë (5) vitesh, këto institucione të ngrisin kapacitete vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e programit të studimit, sipas kërkesave të mësipërme të këtij UA".

Meqenëse dispozita e referuar me lartë i lejon ofrimin e programeve në gjuhën minoritare (turke dhe boshnjake) edhe pa stafin akademik me gradën Dr.sc. paralelisht me programin në gjuhën shqipe, KSHC vendosi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren;
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

